



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. _____ prot.

Lezhe, më _____.____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës- PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Permiresimi i banesave ekzistuese per komunitetet e varfera dhe te pafavorizuara”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45211200-1.

VLERA E FONDIT LIMIT: 17,516,682.60 (shtatembdhjete milion e peseqind e gjashtembdhjete mije e gjashteqind e tetedhejete e dy pike gjashtedhjete) Lek pa TVSH

Argumentimi: Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Lezhe ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit (Shtojcat).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar dhe kërkohej një operator ekonomik i cili të ketë minimumin e kërkuar duke marrë në konsideratë objektin e kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës **31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në nenin 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit permbledhes të vetedeklarimit sipas shtojcës perkatese të DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit të njoftimit të fituesi dhe fillimit të afateve të ankimimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Pagesa e taksave është një detyrim ligjor dhe meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatorët Ekonomike duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,
ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

- Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vlerësimit;
2. Kontratën/Kontratën;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Akt Kolaudimi
5. Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore;
6. Çertifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e perhershme të marrjes në dorezim

-Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratë sipërmarrje;
2. Leje për kryerje punimesh
3. Situacionin përfundimtar;
4. Fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore;
5. Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e perhershme të marrjes në dorezim;

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Shenim: Per punet e ngjashme te realizuara si BOE krahas dokumenteve te mesiperme duhet te paraqitet edhe kontrata e bashkepunimit ku percaktohet ndarja e zerave te punimeve ndermjet paleve, ndersa per punet e ngjashme te realizuara si nenkontraktor duhet te paraqitet kontrata e nenkontraktimit ku percaktohen zerat e punimeve si dhe miratimi i autoritetit kontraktor/investitorit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Përvoja e mëparshme është element shumë i rëndësishëm që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses.

2.3.2 Operatorët Ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, date 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

NP- 3 A Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

NS- 2 A Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.

NS- 4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.

NS- 14 A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktues dhe Energjise, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave

profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton *“Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.”*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve në preventivin e hartuar nga projektuesi pasi aktivitetet kryesore që do të bëjë Kontraktori për perfundimin me sukses të punimeve sipas kontratës në këto objekt janë:

- Mobilizimi
- Furnizimi, Transporti dhe Magazinimi i Materialeve
- Aktivitetet e Punimeve Ndërtimore
- Mbrojtja e Punimeve, ambientit dhe publikut
- Kontrolli laboratorik, Testimi dhe Kontrolli i cilësive të materialeve

Klasat janë përcaktuar referuar Lidhjes 4, të VKM 42/2008, në proporcion me preventivin e punimeve dhe fondin limit dhe janë analizuar në tabelën e mëposhtme:

Kategoria e Licenses	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Vlera e punimeve në preventiv, sipas kategorisë përkatëse
----------------------	--	---

NP-3 A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada	Ne Preventivin e punimeve parashikohen 1. PUNIME HIDROIZOLIMI DHE ÇATITE 2. PUNIME TAVANI DHE SUVATIMI 3. PUNIME BOJATISJE 4. INSTALIME HIDRO-SANITARE DHE NGROHJE 5. INSTALIME PER NDRICIM	0-17,516,682.60
NS-2 A Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.	Ne preventivin e punimeve parashikohen punime per F.V. Lavaman porcelani dhe F.V WC allafrenga, instalime hidraulike	0-17,516,682.60
NS-4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.	Ne preventivin e punimeve parashikohen punime Suva solete ~4 m, me drejtues, me pompe Suva brenda mur tulle ~ 4m, te potpe, II perzier F.V. Dyer te brendeshme tamburate te rimesuara F.V. Dritare d/alumini plastike me dopio xham	0-17,516,682.60
NS-14 A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.	Ne preventivin e punimeve parashikohen punime per instalime elektrike	0-17,516,682.60

2.3.3 Operatoret Ekonomike duhet te kene një punësim mesatar të paktën 20 (njetzet) personave të siguruar për periudhen Maj 2026 – Korrik 2026.

Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:

- a)** Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin nga muajt e kërkuar;
- b)** Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit të mesiperm për numrin minimal të punonjësve duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t'i referohemi projektit, preventivit, raportit teknik, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.4 Operatorët Ekonomikë duhet të kenë pjesë të stafit teknik të shoqërisë dhe të figurojë në Licensën e kompanisë si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi	1 (një)	Diplome Universitare
- Inxhinier Elektrik	1 (një)	Diplome Universitare

-Për stafin e mesiperm Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë: Kontratë pune e vlefshme, Diploma Universitare si dhe të figurojnë në listepagesat e kompanisë së minimalisht për periudhën Maj 2026 – Korrik 2026.

Shenim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i dryshuar, si dhe ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Referuar natyrës dhe objektit të kontratës së prokurimit, shfaqet e nevojshme disponimi i stafit në nivel inxhinieri për realizimin e ketyre punimeve. Kriteri i mësipërm në lidhje me stafin kryesor është lidhur edhe me disponueshmërinë e licencës dhe kriterëve të licencës së kërkuar. Konkretisht në Vendimin 42, datë 16.01.2008 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar parashikohet se: “Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas: I.

Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në: - profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë.”

Sa më sipër, duke marrë parasysh natyrën e punëve të objektit të prokurimit, ka përzgjedhur stafin e drejtuesve teknik, të cilët janë të nevojshëm për realizimin e punimeve. Për më tepër duke qenë se këto punime janë të një rendësie të vecantë dhe në të njëjtën kohë konsistojnë në punime rikonstruksioni vlerësohet e nevojshme që të kerkohen specialist të fushave inxhinierike si: Inxhinier Ndërtimi dhe Inxhinier Elektrik.

Në lidhje me kërkesën e Drejtuesit Teknik Inxhinier Ndërtimi, njësia e prokurimit ka marrë në konsideratë se projektet për punime rikonstruksionin e banesave ku përfshin punime për Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, dhe ka si qëllim kryesor që të sigurojë ambiente të përmirësuara banimi dhe përfshin kryesisht punime ndërtimi.

Në lidhje me kërkesën e Drejtuesit Teknik Inxhinier Elektrik njësia e prokurimit mbanë në konsideratë se projekti përfshin punime elektrike në një sasi të konsiderueshme dhe është e nevojshme që këto punime të kryhen nën kujdesin e Inxhinierit Elektrik

Sa më sipër analiza e ketyre të dhënave dhe kontrolli i nevojshëm në të gjithë etapën e punës që kerkohet të realizohet, kërkon minimalisht inxhinieret e kerkuar.

2.3.5 Krahas stafit teknik Operatorët Ekonomikë duhet të kenë të punësuar staf mbështetës si më poshtë:

- Teknik Ndërtimi	1 (nje)	Diplome shkolle mesme
- Teknik Elektrik	1 (nje)	Diplome shkolle mesme
- Teknik Hidraulik	1 (nje)	Diplome shkolle mesme
- Suvatues	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Plakashtues	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Hidraulik	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Elektricitist	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Bojaxhi	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Hidroizolues	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Marangoz	1 (nje)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Shofer	2 (dy)	Leje Drejtimi

Operatori ekonomik duhet të paraqes për stafin e mesipër: Kontratën individuale të punës, Diplome të shkolle mesme/ Dëshmitë profesionale/ Leje Drejtimi sipas shënimeve për çdo kategori të mesipërme si dhe stafi i mesipër të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Maj 2026 – Korrik 2026.

V.O- Dokumentacioni (Diplomat/dëshmitë/certifikatat) që nuk janë leshuar sipas legjislacionit përkatës të arsimimit profesional do të konsiderohen jo të sakta dhe behen shkak për veprime të mëtejshme sipas parashikimeve përkatëse të ligjit të prokurimit publik.

Për profesionet si më sipër, operatori ekonomik duhet të plotësojë tabelën si më poshtë:

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni i punojesis ne certifikate/diplome	Emri i Institucioni publik/privat leshues i certifikates/diplomes	Numri indetifikues i certefikates/diplomes	Nr NIPT - (Ne rast se leshuesi eshte institucion privat)
1					
2					
.....					

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe tabelës se mesiperme, te cilat duhet te dorezohen ne fazen e ofertimit ne SPE. Ndersa dokumentacioni provues i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit paraprak dhe fillimit te afateve te ankimit.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur ne bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjin nr. 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Per stafin mbështetës, në lidhje me kualifikimet janë parashikuar nivele si Diplome e shkolles mesme/ Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/ Leje Drejtimi etj, te cilat janë dokumente zyrtare të llojeve të ndryshme, të lëshuara nga institucione shtetërore, të cilat regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit, sipas një procedure e standardi të paracaktuar.

Po ashtu profilet e kerkuar dhe numri i tyre, janë kerkuar në proporcion me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit, duke marrë në konsideratë edhe zërat konkretë të preventivit të zbatimit të punimeve, volumit te tyre, , si dhe mjeteve qe duhet te jene ne dispozicion, pasi parashikohen punime te natyres per 1. Punime Shtresash, 2. Instalime Hidro-Sanitare dhe Ngrohje, 3.Punime hidroizolimi dhe çatite, 4.Punime tavani dhe suvatimi, 5.Punime bojatisje, 6.Instalime per ndricim, 7.Instalime Hidraulike etj.

Njesia e Prokurimit thekson se punimet konsistojne ne rikonstruksionin 17 banesave e cila do te kene nevojë per kryerjen e punimeve nga stafi mbeshtetes i kerkuar, kjo bazuar edhe ne zerat e preventivit te hartuar nga projektuesi.

Po ashtu, Njesia e Prokurimit thekson se duke marre ne konsiderate mjetet minimale te nevojshme per kryerjen e punimeve eshte perllogaritur edhe numri i shofereve qe duhen.

Sa me siper me qellim realizimin e punimeve ne perputhje me specifikimet teknike dhe zbatimin me sukses te kontrates si dhe kontrollin e nevojshem ne te gjithë etapat e punes qe kerkohet te realizohet, kerkon miminalisht stafin e kerkuar.

2.3.6 Operatoret Ekonomike duhet te kene ne stafin teknik ose mbeshtetes, te certifikuar te pakten:

2.3.6/a -1 (nje) punonjes te pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese kontrate pune, certifikaten perkatese si dhe duhet të jetë ne listëpagesat e shoqerise të paktën për periudhën Maj 2026 – Korrik 2026.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjin nr. 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

2.3.7 Operatoret Ekonomike duhet te disponoje mjetet e meposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 10 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
2	Kamion me Vinc	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
3	Kamionçina me kapacitet mbajtese min 6 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
4	Betonierte kantieri	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	2
5	Pompe Suvatimi	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1

Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e meposhtme:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetohet pronesinë e mjetit: - certifikatën e pronesisë; -leja e qarkullimit; -certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin; - taksat vjetore- leja e transportit, si dhe të paraqesë foto të qarte për secilin mjet dhe të jetë e dukshme targa e mjetit.
- Ndersa për mjete të marra me qera/kontrate bashkëpunimi krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerash/ bashkëpunimit.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndersa për mjete të marra me qera/ Kontrate bashkëpunimi, krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerash/ Kontrate Bashkëpunimi.

Shenim: Kjo kerkese përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronesi/qera ose kontrate bashkëpunimi janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Sasia e mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Njesia e prokurimit thekson se mjetet e transportit nevojiten për transportimin e materialeve të ndërtimit dhe kryerjen e punimeve.

2.3.8 Operatori ekonomik në rast se nuk është prodhues duhet të paraqesë kontratë e furnizimit për materialet si më poshtë:

2.3.8/1 Për Bojrat

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

2.3.8/2 Për Materialet hidroizoluese dhe suvase:

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

2.3.8/3 Per Materialet Elektrike:

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

2.3.8/4 Per Materialet Hidraulike:

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Ky kriter vendoset bazuar në zerat e preventivit të punimeve që do të realizohen dhe rendesise se vecante të objektit të prokurimit, duke marrë në konsideratë se punimet realizohen në godina në objekte civile që shfrytëzohet nga banuesit.

Meqenëse punimet do të kryhen në një objekt që kërkon kujdes të veçantë për shkak të frekuentimit nga familjet banuese shfaqet e nevojshme që për mallrat që do të perdoren në realizimin e punimeve, Autoriteti Kontraktor të garantohet që këto mallra furnizohen nga prodhues apo distributor të autorizuar dhe në cilësi të duhur.

2.3.9 Operatoret Ekonomike ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- **ISO 9001:2015**, mbi “Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalentin e saj
- **ISO 45001:2015**, mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe sigurisë në punë”, ose ekuivalentin e saj

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Referuar natyrës së veçantë, vendndodhjes dhe përmasave të objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë sigurisë në punë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i

shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Shenim: Per cdo emertim marke apo cilesie te shenuar ne preventivin e punimeve do te pranohet edhe ekuivalenti i tij.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Njesia pergjegjese ka hartuar/konfirmuar specifikimet teknike, ku jane shprehur qarte kerkesat AK per realizimin e kontrates.

Njesia pergjegjese ne specifikimet teknike argumenton se nuk ka permendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

NJËSIA E PROKURIMIT